

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS,
AMBASADORIT VINCENZO DEL MONACO, NË KONFERENCËN
“VOTIMI NGA JASHTË VENDIT, KOHA ËSHTË TANI!”**

24 maj 2022

- I nderuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve z. Ilirjan Celibashi, zonja Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë, zonja ambasadore, shkëlqesi, përfaqësues të partive politike, të nderuar pjesëmarrës që jeni në sallë dhe pjesëtarë të diasporës që po na ndiqni me anë të internetit. Është kënaqësi e vërtetë të jem këtu me të gjithë ju, partnerë dhe kolegë.
- Kur u njoha para ca kohësh me idenë e organizimit të konferencës së sotme të përbashkët, iu përgjigja menjëherë **“PO”** Komisionerit Celibashi, pa pikën e ngurrimit. Arsyeja e mbështetjes së menjëhershme nga unë dhe ekipi im është mjaft e qartë. Koha është **tani** për të filluar punën për zbatimin e së drejtës për votimin nga jashtë vendit, një e drejtë që shqiptarëve ua njeh Kushtetuta. Të gjithë shqiptarët meritojnë që interesat e tyre të përfaqësohen, meritojnë të kontribuojnë në jetën politike të atdheut të tyre, t’u kërkojnë llogari të zgjedhurve të tyre, pavarësisht se ku jetojnë, në Shqipëri dhe jashtë saj.
- Për të theksuar urgjencën – si edhe rëndësinë politike të kësaj konference – le të kujtojmë se, sipas statistikave zyrtare, më shumë se 1/3 e popullsisë së Shqipërisë banon jashtë, nga të cilët më shumë se 1,3 milionë kanë të drejtën për të votuar.¹ Kjo është një pjesë e madhe të popullatës, e cila ka dhënë kontribut për zhvillimin dhe mirëqenien ekonomike e kulturore të vendit dhe që do të vazhdojë ta bëjë një gjë të tillë, gjë që është tejet fitimprurëse për Shqipërinë në botë.
- Votimi nga jashtë vendit është përparësi edhe për sa i përket qeverisjes, mirëqeverisjes. Është një mundësi për Shqipërinë. Gjetjet e një raporti të kohëve të fundit të agjencisë suedeze të asistencës, SIDA, të titulluar “Vështirësi shumëpërmasor i Ballkanit Perëndimor: Nga analiza tek aksioni, mirëqeverisja në çështjet ekonomike dhe mjedisore”, janë më se të qarta. Ato flasin për të ushqyerit e lidhjeve më të forta me diasporën për të vënë në lëvizje dhe për t’u mbështetur te rrjetet e saj të profesionistëve. Nëse më lejoni t’i interpretoj politikisht këto gjetje, do të thosha se nëse do të doni të keni ndihmën e diasporës për të tërhequr investime, për t’i vënë remitancat në përdorim produktiv dhe për të siguruar kalimin e dijeve nga diaspora në Shqipëri, atëherë, pikë së pari, duhet forcuar lidhjet e tyre politike dhe qytetare me atdheun, duke u lejuar të votojnë nga jashtë.
- Në fakt, dëshiroj të shpreh vlerësimin tim për aktorët politikë që arritën të gjenin mirëkuptim në vitin 2020 për t’i shtuar Kodit Zgjedhor dispozita që mundësojnë votimin nga jashtë vendit. Vizioni i tyre ishte i patëmetë dhe dispozitat e hartuara prej tyre ishin të duhurat. Ato tani duhen vënë në jetë plotësisht.
- Sikurse mund ta dini, nuk ka rekomandime të OSBE/ODIHR-it dhe as standarde ndërkombëtare për votimin nga jashtë vendit. Vendimi për ta zbatuar atë i takon secilit shtet veçmas – në këtë rast, autoriteteve shqiptare. Për zbatimin e të gjitha dispozitave të Kodit

¹ Të dhënat e botuara nga Instituti i Statistikës, në dhjetor të vitit 2020, tregojnë se rreth 1 684 135 (37%) persona banojnë jashtë vendit. [diaspora-ne-shifra-2020.pdf \(instat.gov.al\)](https://www.instat.gov.al/diaspora-ne-shifra-2020.pdf)

Zgjedhor, nevojiten përpjekje të përbashkëta të të gjitha institucioneve të përfshira (KQZ-së, Kuvendit, qeverisë, diasporës) dhe të shoqërisë civile.

- Nga ana e Prezencës në Shqipëri, përsëris këtu gatishmërinë tonë për t'u vënë në dispozicion ekspertizën tonë të gjithë aktorëve të përfshirë, duke plotësuar hendeqet e mundshme, në mënyrë që, në të ardhmen, kur votimi nga jashtë vendit të jetë bërë i mundur, të mos ketë rekomandime të ODIHR-it lidhur me të. Që nga viti 2018, Prezenca ka ndihmuar zhvillimin e diskutimeve për votimin nga jashtë vendit, duke mbështetur Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisionin e Posaçëm të atëhershëm për Reformën Zgjedhore në organizimin e tryezave të posaçme të punës për këtë temë. Rishtazi, në fund të vitit 2020, Prezenca gjithashtu mbështeti KQZ-në nëpërmjet ofrimit të një studimi krahasues të modeleve të ndryshme të votimit nga jashtë vendit nga pesë shtete evropiane² – gjatë seancës së pasdites, eksperti i kontraktuar nga Prezenca, i cili përgatiti studimin, do t'i përshkruajë më me hollësi këto modele.
- I di shumë mirë sfidat që ju presin. Mbi të gjitha, mekanizmi i sistemit të votimit nga jashtë vendit duhet të ofrojë ekuilibër ndërmjet garantimit të të drejtës së votës për të gjithë votuesit që banojnë jashtë Shqipërisë dhe përmbushjes së standardeve të integritetit, transparencës dhe sigurisë, për të siguruar besimin te procesi zgjedhor.
- Për këtë arsye, duhen shqyrtuar me kujdes aspektet administrative dhe logjistike të procesit – duke filluar me regjistrimin e zgjedhësve që banojnë jashtë vendit, metodën e votimit dhe të numërimit, kostot e burimeve financiare dhe njerëzore, etj., në mënyrë që të tkurret që në nisje ndonjë mosbesim i arsyeshëm në lidhje me procesin. Besimi është sërish një fjalë kyçe, të cilën e kam dëgjuar vazhdimisht që në nisje të mandatit tim në Tiranë. Është fjalë, është nocion, është një objektivi për të cilin ne si OSBE jemi plotësisht të përkushtuar.
- Shqipëria është një prej shtete fare të pakta në zonën e OSBE-së që ende nuk ua mundëson qytetarëve të saj votimin nga jashtë vendit.³ Në këto rrethana dhe me mjaft kohë në dispozicion deri në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025, Shqipëria ka një mundësi të shkëlqyer për të mësuar nga përvoja e shteteve të tjera dhe për të zbatuar model që u përshtatet më shumë nevojave të vendit dhe të qytetarëve.
- Konferenca e sotme nuk duhet parë si pikëmbërritje, por vetëm si nisje e një diskutimi më të gjerë rreth një procesi serioz dhe konkret, i cili duhet të jetë i hapur për sugjerime dhe të mundësojë konsultime kuptimplota me të gjitha palët e interesuara, veçanërisht me diasporën.
- Punë të rëndësishme na presin në të ardhmen. Në të Prezencës së OSBE-së, së bashku me kolegët e ODIHR-it, jemi plotësisht të gatshëm të ndihmojmë dhe të vijojmë të ofrojmë mbështetje. Faleminderit edhe një herë, i nderuar Komisioner, juve dhe ekipit tuaj, ekipit tim, për organizimin e kësaj konference.
- Ju uroj të gjithëve diskutime konkrete dhe të frytshme sot!

² Kombinim i qëllimshëm i modeleve të vendeve të BE-së /jo të BE-së dhe të Ballkanit/pjesës tjetër të Evropës: Austria, Kroacia dhe Sllovenia, MV dhe BH.

³ Sipas bazës së të dhënave Ndërkombëtare IDEA, Shqipëria së bashku me Malin e Zi, Maltën, San Marinon dhe Selinë e Shenjtë janë të vetmet vende në Evropë dhe në zonën e OSBE-së që nuk mundësojnë votimin nga jashtë vendit. [Europe | International IDEA: Out-of-Country Voting \(idea.int\)](https://www.idea.int/europe-international-idea-out-of-country-voting)